

VENDIM
Nr. 491, datë 13.6.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 310, DATË 21.4.2011 “PËR PËRCAKTIMIN E KOSTOS MESATARE, LEKË PËR METËR KATROR, PËR OBJEKTET SHITËTËRORE TË TRANSFORMUARA NË FOND BANESASH, KALUAR NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE, ME QËLLIM PRIVATIZIMI PËR BANORËT POSEDUES, SIPAS VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË PERIUDHËS 2009-2011”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe të nenit 34/1 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit në zonat urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në titull dhe kudo në përmbajtje të vendimit nr. 310, datë 21.4.2011 të Këshillit të Ministrave, togfjalëshi “...periudhës 2009-2011...” zëvendësohet me “...periudhës 2009-2013...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha